

ANTIBACTERIAL



PËRSHKRIMI

Antimolë me bazë uji që ofron mbrojtjen dhe ngjyrosjen perfekte të drurit për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Gjendet në 20 ngjyra
- Ngjitje shumë e fortë dhe tharje e shpejtë
- Mbron dhe ofron një pamje të bukur të drurit
- Ngjyra të qëndrueshme për një kohë të gjatë
- Elastik dhe rezistent ndaj plasaritjeve, pjesëve të ngritura dhe dhëmbëzimeve
- Depërton drurin dhe e mbron atë nga kërpudhat, njollat blu dhe mola

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Ideale për sipërfaqet e drurit si dyert, dritaret, kornizat, dollapet, mobiljet e kopshtit, strehat, traversat dhe trarët, gardhet etj.

PERGATITJA E PRODUKTIT

Bëni përzierjen e produktit duke tundur mirë ambalazhin.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Pastroni sipërfaqet nga boja e vjetër e dëmtuar, e pa ngjitur dhe pjesët e shkëputura duke bërë zmerilimin e sipërfaqes së drurit. Me anën e procesit të pastrimit me ajër eliminoni të gjithë pluhurat e krijuar nga procesi i zmerilimit si dhe elemente të tjera që pengojnë ngjitjen si graso, vajra, etj.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	akrilike
Densiteti EN ISO 2811-1	1 gr/ml
Mbetja e thatë EN ISO 3251	72%
Shkalla e hollimit	10 – 20%
Viskoziteti	115 ± 5 KU
Koha e tharjes	3 - 4 orë Në varësi edhe të kushteve të ambientit dhe diluentit të përdorur
VOC në produktin e gatshëm (Di rektiva Europiane 2004/42/EC) (g/l)	≤ 100
VOC emetimi në ambient, dhomë simulimi ISO 16000 (mg/m3)	≤ 20

APLIKIMI I PRODUKTIT

Aplikimi i produktit Antibacterial bëhet me anën e një pistolette me ajër, me furçë ose me rrul. Fillimisht hidheni produktin e përgatitur në enën mbajtëse. Më pas me anën e pistoletës, furçës ose rrulit bëhet hapja e produktit mbi sipërfaqen e drurit. Aplikimi bëhet duke aplikuar dy shtresa të njëpasnjëshme në mënyrë që të bëhet mbushja sa më e mirë e sipërfaqes së drurit. Sigurohuni që druri të përthithë sasinë e duhur në mënyrë që të arrihet mbrojtja maksimale e tij. Pastroni mjetet e punës menjëherë pas përdorimit duke përdorur pastrues me bazë uji.

PAKETIMI

Kanace 0.75lt

RUAJTJA

36 muaj, me kusht që kanaçet të jenë të mbyllura dhe në kushte normale ruajtjeje.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

SHËNIME

- Rekomandohet që të shmanget aplikimi i produktit në temperatura nën 5°C

